

**Vendim nr. 58 datë 02.04.2021**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Vitore Tusha,	Kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska,	Anëtare e “ “
Përparim Kalo,	Anëtar i “ “

në datën 02.04.2021 mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr. 1(I)2021 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ILIR MALINDI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit normativ nr. 1, datë 31.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike” si i papajtueshëm me Kushtetutën. **Pezullimi i menjëhershëm i zbatimit të tij.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 30 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 4 i Kodit të Procedurës Penale; neni 11 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 31.01.2020 Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 1 “Për masat parandaluese në kuadrin e forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”. Ky akt është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 10, të datës 1 shkurt 2020.

2. Akti i lartpërmendur është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 18/2020, datë 05.03.2020, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, të datës 22 prill 2020.

3. Kërkuesi Ilir Malindi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, pasi Operacioni Forca e Ligjit, i krijuar me aktin normativ nr. 1, datë 31.01.2020(akti nr. 1/2020)të Këshillit të Ministrave si strukturë e veçantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, ka sekuestruar automjetin e djalit të tij, A.M., si dhe ka marrë nën hetim djalin tjetër të tij, G.M., për të cilin nuk është dhënë ende vendim gjyqësor.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese(Gjykata), duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se:

4.1. Akti i kundërshtuar cenon parimin e prezumimit të pafajësisë të djalit të tij, G.M., i cili është ende nën hetim, si dhe djalit tjetër të tij, A.M, pasi i kalon atij barrën e provës për të justifikuar të ardhuratme të cilat është blerë automjeti, çka është detyrim i organeve të ndjekjes penale. Ai pretendon se të ardhurat janë përfituar nga puna e bashkëshortes në Greqi, por në kushtet aktuale, për shkak të mbylljes së kufijve, është e pamundur marrja nga shteti i huaj i dokumenteve që justifikojnë këto të ardhura. Ndërkohë, prokuroria nuk ka pranuar kërkesën e kërkuesit për pezullimin e gjykimit deri në paraqitjen e dokumenteve në fjalë.

4.2. Sipas kërkuesit, pikat 4 dhe 5 të nenit 18 të aktit nr. 1/2020 të Këshillit të Ministrave, më konkretisht pjesa që parashikon se vendimi gjykatës për vendosjen e masës së sekuestros ekzekutohet menjëherë, edhe pa marrë vendimi formë të prerë, janë antikushtetuese. Akti imbibendoset ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, madje e shpërfill atë, duke nxjerrë dispozita të tjera antikushtetuese.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

5. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

6. Nga ana tjetër, edhe neni 134, pika 2, i Kushtetutës, ndërkohë që përcakton subjektet që gëzojnë të drejtën për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e aktit normativ, i klasifikon ato në subjekte me legjitimitet të pakushtëzuar dhe në subjekte me legjitimitet të kushtëzuar. Individët, sipas këtij neni, bëjnë pjesë në grupin e dytë, pra janë subjekte me legjitimitet të kushtëzuar.

7. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen bashkërisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

8. Kolegji vëren se referuar neneve 71, pika 2 dhe 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, individët mund t’i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës për të kërkuar shfuqizimin e ligjit ose të akteve të tjera normative, kur pretendojnë se u janë cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

9. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka theksuar se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur shqyrtohen ankesa individuale kushtetuese, në bazë të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore kushtetuese bëhet i mundur kur kërkuuesi kashfrytëzuar, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të

çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi(*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kolegji vëren se, në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës drejtpërsëdrejti, duke kërkuar shfuqizimin e aktit nr. 1/2020 të Këshillit të Ministrave. Në kërkesën e tij, në thelb, ai pretendon se dispozitat e aktit cenojnë parimin e prezumimit të pafajësisë si të djalit të tij, G.M., nën hetim, ashtu edhe djalit tjetër të tij A.M., pasie kalon barrën e provës për blerjen e automjetit nga autoritetet e ndjekjes penale të personi i dyshuar.

11. Kolegji thekson se kërkuesi nuk mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese për kundërshtimin e aktit normativ nr. 1/2020 të Këshillit të Ministrave, pasi ai nuk provon, përmes një akti individual të nxjerrë në zbatim të aktit normativ, që t'i kenë ardhur pasoja negative konkrete. Pra, kërkuesi duhet të provojë se si e se sa është cenuar drejtpërdrejt nga akti normativ i kundërshtuar.

12. Gjithashtu, Kolegji vëren se në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi ka pretenduar se automjeti i djalit të tij, A.M., është marrë fillimisht forcërisht nga policia e rrethit Durrës dhe se ndaj këtij automjeti është vendosur sekuestro në muajin maj të vitit 2020. Ndërkohë, edhe në lidhje me këto pretendime, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë akt individual që do të provonte pasojën negative të ardhur ndaj tij. Po kështu, edhe për sa i përket djalit tjetër të tij, G.M., i cili, sipas tij, është ende nën hetim, nuk rezulton që kërkuesi t'i ketë bashkëlidhur kërkesës ndonjë dokument provues mbi pasojat negative dhe të drejtpërdrejta, për cenimin e të drejtave dhe liritetë parashikuara në Kushtetutë.

**13. Pavarësisht nga sa parashtrohet më lart, Kolegji vëren se legjislacioni në fuqi parashikon mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të cenuara gjatë gjykimit të çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese.**

14. Si përfundim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe neneve 49, pika 3, shkronja "e" dhe 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**VENDOSI:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

[shqiptarja.com]